REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosova
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije
Ministry of Finance
Arkiva - Arhiva - Archive
Njësia Org. / Org. Jedin. / Org. Unit: 01
Nr. Prot. / Br. Prot. / Prot. No.: 2112
Nr. i fletëve / Broj stranica / No. pages: 11
Data / Datum / Date: 07/10/2016
Hyrëse
PRISHTINË/A

# Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Financave*
*Ministarstvo za Finansije – Ministry of Finance*

*Zyra e Ministrit / Kancelarija Ministra / Cabinet of the Minister*

| | |
|---|---|
| **DATË/A:** | 07. 10 . 2016 |
| **PËR/ZA/TO:** | **Ministrat**<br>**Udhëheqësit e organizatave buxhetore**<br>**Zyrtarët për buxhet të organizatave buxhetore** |
| **NGA/OD/FROM:** | **Avdullah Hoti, Ministër i Financave** |
| **TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:** | **Qarkorja buxhetore 2017/02: Shpallja e kufijve final buxhetor për vitin 2017** |

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E FINANCAVE / MINISTARSTVO ZA FINANSIJE / MINISTRY OF FINANCE

Të nderuar Ministra,
Të nderuar udhëheqës dhe zyrtar të organizatave buxhetore,

Të bashkëngjitur keni Qarkoren Buxhetore 2017/02, e cila përcakton kufijtë e fortë buxhetor për organizatat buxhetore të nivelit qendror, instruksionet për përpilimin e buxhetit për vitin 2017 si dhe afatet kohore që duhet t'i përmbahet çdo organizatë buxhetore.

Me respekt!

## Qëllimi

Me këtë qarkore të dytë buxhetore – 2017/02, përmbyllet propozim-buxheti për vitin 2017 nga ana e Ministrisë së Financave. Përmes qarkores, ju pranoni kufijtë final buxhetor, të cilët duhet t'i ndani nëpër programe dhe nën-programe si dhe nëpër kategori dhe nën-kategori ekonomike të organizatës suaj buxhetore. Këta kufij buxhetor mund t'i ndryshoj në të ardhmen vetëm Qeveria dhe Kuvendi duke respektuar kufijtë e jashtëm buxhetor.

Më 15 maj 2016, Ministria e Financave ka lëshuar qarkoren e parë buxhetore 2017/01, ku janë ofruar udhëzimet e para, kalendari indikativ si dhe kufijtë fillestar të përgatitjes së buxhetit për vitin 2017 dhe vlerësimet për vitet 2018-2019. Gjithashtu jeni informuar rreth kontekstit së përgatitjes së buxhetit për vitin 2017, i cili rrjedh nga KASH 2017-2019 i miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës në prill të vitit 2016.

Në këtë drejtim, dorëzimet paraprake buxhetore janë plotësuar me informata shtesë që tregojnë arsyeshmërinë e plotë të kërkesave buxhetore dhe njëkohësisht janë marrë në konsideratë edhe rivlerësimi i të hyrave buxhetore dhe ndryshimet e mundshme të cilat kanë mundur të paraqiten gjatë ekzekutimit të buxhetit 2016 e të cilat ndikojnë edhe në buxhetin e vitit 2017 dhe buxhetet e viteve vijuese.

Kufijtë e përgjithshëm të shpenzimeve të paraqitur me këtë qarkore 2017/02 janë në harmoni me zotimet tona në raport me institucionet financiare ndërkombëtare. Në këtë kontekst, buxheti i vitit 2017 dhe ai i viteve pasuese 2018-2019 është vazhdimësi e KASH 2017-2019 dhe është në pajtim me politikat fiskale–buxhetore, për të cilat Qeveria është pajtuar me Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN). Qeveria e Republikës së Kosovës është e përkushtuar në rend të parë të ruajë stabilitetin fiskal dhe buxhetor si dhe zbatimin e rregullës fiskale e cila përcakton kufirin e nivelit të deficitit buxhetor në 2% të BPV-së. Qeveria përkrah kërkesat e organizatave buxhetore dhe prioritetet e tyre, që janë në harmoni me Strategjinë Zhvillimore Kombëtare dhe Programin e Qeverisë 2015-2018, brenda kornizës buxhetore.

Gjatë periudhës kohore 29 gusht 2016 - 9 shtator 2016, janë mbajtur dëgjimet buxhetore me të gjitha organizatat buxhetore. Gjatë këtyre dëgjimeve të gjitha organizatat buxhetore janë njoftuar me implikimet e Marrëveshjes së Qeverisë me FMN në buxhetin për vitin 2017 dhe vlerësimet për vitet 2018-2019. Nga organizatat buxhetore u kërkua përafrim me kufijtë e lëshuar buxhetor. Gjithashtu, organizatave buxhetore u është bërë e ditur se shtimi i numrit të punëtorëve apo çdo avancim në koeficient apo pozita pune nuk mund të bëhet përtej kufirit të lëshuar me qarkore buxhetore. Ministria e Administratës Publike nuk do të aprovoj asnjë punësim të ri para se ta marr opinionin pozitiv nga Departamenti i Buxhetit. E gjithë kjo do të jetë në funksion të menaxhimit më efektiv të financave publike dhe punësimit në sektorin publik. Dëgjimet buxhetore ishin të dobishme dhe komentet e juaja janë marrë parasysh brenda mundësive buxhetore në këtë qarkore.

Në buxhetin e vitit 2017 risi do të jenë planifikimi i buxhetit dhe përcjellja e ekzekutimit të këtij planifikimi në nivel të kodeve pesë-shifrore. Duhet të pasur kujdes në planifikimin e buxhetit dhe shpërndarjen e mjeteve të planifikuara në mënyrë objektive nëpër nën-kategori (nën-zëra). Do të ofrohen udhëzimet e nevojshme për mënyrën e aprovimit si dhe masën e lejuar të zhvendosjes-rialokimit nga një nënkategori (nënzëri) në tjetrën.

Sa i përket klauzolës së investimeve dhe shumës së planifikuar për projekteve investive, një pjesë tanimë janë planifikuar për projekte të caktuara, ndërsa pjesa tjetër do të jetë linjë e veçantë buxhetore e cila do të ndahet me vendim të Qeverisë nëpër organizata buxhetore sipas marrëveshjeve për financim në mes Qeverisë dhe Institucioneve Financiare Ndërkombëtare. Gjithashtu, do të jetë një tjetër linjë e veçantë buxhetore për financimin e projekteve kapitale nga fondet e Agjensionit Kosovar të Privatizimit (AKP). Mjetet e planifikuara për investim nga fondet e AKP do të alokohen nëpër projekte individuale sipas dinamikës së transferit të mjeteve nga AKP në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Mjetet e ndara në buxhetin e secilës organizatë buxhetore duhet të shfrytëzohen në rend të parë për kryerjen e obligimeve ekzistuese kontraktuale.

Kufijtë e shpenzimeve për vitin 2017 përmes qarkores së dytë buxhetore 2017/02, paraqesin kufijtë final buxhetor për organizatën buxhetore në total dhe sipas kategorive ekonomike. Çdo hyrje në obligime përtej kufijve buxhetor paraqet shkelje të Ligjit të Buxhetit. Nisur nga këto dokumente dhe rekomandime të dala nga dëgjimet e mbajtura, organizatat buxhetore janë të obliguara të përshtasin kërkesat e tyre buxhetore sipas situatës së re dhe të rishqyrtojnë politikat e tyre dhe të bëjnë prioritizimin brenda kufijve të dhënë buxhetor, të cilët shpërndahen nëpër programe, nën-programe, kategori dhe nën-kategori ekonomike.

Në totalin e kufirit buxhetor për organizatën buxhetore, krahas granteve dhe shpenzimeve të lejuara nga të hyrat vetanake, duhet të përfshihen gjithsesi edhe burimet e financimeve nga huamarrja.

Nga organizatat buxhetore kërkohet t'i fusin të dhënat në Sistemin për Zhvillimin dhe Menaxhimin e Buxhetit (SZHMB) dhe Sistemin e Programit të Investimeve Publike (PIP) në pajtim me kufijtë buxhetor deri në nivel të kodeve pesë-shifrore.

Organizatat buxhetore duhet t'i dorëzojnë kërkesat e tyre më së largu më **12 tetor 2016** në Ministrinë e Financave në tri gjuhët: shqipe, serbe dhe angleze. Materialet dorëzohen në kopje fizike në Arkiv dhe elektronike analistit përkatës të buxhetit në Ministrinë e Financave.

Kërkesa duhet të përfshijë:

1. Letër kërkesa (shkresa përcjellëse) e firmosur/nënshkruar nga Ministri apo Sekretari i Përgjithshëm dhe Kryeshefi i agjencionit, bashkangjitur të gjitha materialet buxhetore.
2. Formularët e PCF-së nga sistemi i SZHMB dhe
3. Formularët e shtypur nga Sistemi PIP.

Për çdo paqartësi lidhur me këtë qarkore, ju lutem kontaktoni me analistin e juaj të buxhetit në Ministrinë e Financave.

Të bashkangjitur gjeni Shtojcën 1, e cila përcakton kufijtë final të shpenzimeve për organizatat buxhetore.

Me respekt!

**Shtojca 1. Kufijtë e Buxhetit për vitin 2016 si dhe vlersimet për vitet 2017-2018**

| | | Kufiri i buxhetit për vitin 2017 | | | | | | | | Vlerësimet për vitin 2018 | | | Vlerësimet për vitin 2019 | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Kodi org. | Ministritë/Institucionet | Nr. i punëtorëve | Paga dhe Mëditje Totali | Mallra dhe Shërbime | Shpenzimet Komunale | Subvencione dhe Transfere | Shpenzimet Kapitale | Rezerva | Total 2017 | Shpenzime Operative 2018 | Shpenzime Kapitale 2018 | Total 2018 | Shpenzime Operative 2019 | Shpenzime Kapitale 2019 | Total 2018 |
| 101 | Kuvendi i Kosovës | 357 | 6,298,756 | 1,688,759 | 241,000 | 140,000 | 1,300,000 | - | 9,668,515 | 8,400,009 | 1,310,000 | 9,710,009 | 8,462,997 | 1,320,000 | 9,782,997 |
| 102 | Zyra e Presidentit | 70 | 772,312 | 770,421 | 18,700 | 70,000 | 15,000 | - | 1,646,433 | 1,635,294 | 20,000 | 1,655,294 | 1,643,017 | 25,000 | 1,668,017 |
| 104 | Zyra e Kryeministrit | 679 | 4,543,200 | 3,159,627 | 184,133 | 1,480,000 | 5,225,994 | | 14,592,954 | 9,389,676 | 5,300,000 | 14,689,676 | 9,435,108 | 5,120,000 | 14,555,108 |
| 201 | Ministria e Financave | 1,802 | 32,307,238 | 5,151,366 | 488,592 | 226,000 | 24,030,000 | - | 62,203,196 | 61,539,029 | 20,617,250 | 82,156,279 | 94,085,874 | 67,019,823 | 161,105,697 |
| 202 | Ministria e Administrimit Publik | 270 | 2,042,922 | 4,773,852 | 2,499,600 | | 8,270,000 | | 17,586,374 | 9,326,588 | 9,250,000 | 18,576,588 | 9,347,017 | 10,500,000 | 19,847,017 |
| 203 | Ministria e Bujqësisë, Pyllitarisë dhe Zhvillimit Rural | 382 | 2,319,195 | 2,981,681 | 118,768 | 47,203,922 | 2,552,292 | | 55,175,858 | 52,635,162 | 2,850,000 | 55,485,162 | 52,658,354 | 3,200,000 | 55,858,354 |
| 204 | Ministria e Tregtisë dhe Industrisë | 231 | 1,510,347 | 1,744,765 | 109,280 | 2,050,000 | 1,850,000 | | 7,264,392 | 5,421,944 | 1,900,000 | 7,321,944 | 5,437,047 | 2,000,000 | 7,437,047 |
| 205 | Ministria e Infrastrukturës | 296 | 1,718,796 | 5,903,323 | 375,190 | 1,443,814 | 249,538,187 | | 258,979,310 | 9,449,717 | 210,114,000 | 219,563,717 | 9,466,905 | 190,000,000 | 199,466,905 |
| 206 | Ministria e Shëndetsisë | 1,105 | 7,799,900 | 27,760,887 | 230,548 | 7,803,725 | 10,082,000 | | 53,677,060 | 43,634,060 | 10,105,000 | 53,739,060 | 43,712,059 | 11,150,000 | 54,862,059 |
| 220 | Sherbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosoves | 6,720 | 50,914,864 | 10,975,909 | 3,591,416 | | 5,232,378 | | 70,714,567 | 65,736,763 | 5,510,000 | 71,246,763 | 66,245,911 | 5,520,000 | 71,765,911 |
| 207 | Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve | 674 | 3,512,256 | 925,467 | 334,323 | 7,206,550 | 11,648,684 | | 23,627,280 | 11,996,157 | 11,750,000 | 23,746,157 | 12,031,279 | 14,500,000 | 26,531,279 |
| 208 | Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë | 2,065 | 15,931,068 | 9,302,672 | 1,245,259 | 3,821,929 | 14,745,000 | | 45,045,928 | 30,380,583 | 15,210,000 | 45,590,583 | 30,539,894 | 15,500,000 | 46,039,894 |
| 209 | Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale | 850 | 4,970,177 | 1,772,538 | 377,085 | 370,961,674 | 838,000 | | 378,919,474 | 385,106,325 | 860,000 | 385,966,325 | 392,156,026 | 1,088,000 | 393,244,026 |
| 210 | Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor | 335 | 2,095,821 | 1,118,081 | 83,220 | | 42,476,541 | | 45,773,663 | 3,307,601 | 45,250,000 | 48,557,601 | 3,328,559 | 48,500,000 | 51,828,559 |
| 211 | Ministria e Komuniteteve dhe Kthimit | 114 | 755,710 | 375,652 | 26,154 | 300,000 | 6,400,000 | | 7,857,516 | 1,461,294 | 6,500,000 | 7,961,294 | 1,468,851 | 6,550,000 | 8,018,851 |
| 212 | Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal | 151 | 976,455 | 254,431 | 25,500 | 203,649 | 3,500,000 | | 4,960,035 | 1,464,917 | 3,620,000 | 5,084,917 | 1,474,681 | 3,850,000 | 5,324,681 |
| 213 | Ministria e Zhvillimit Ekonomik | 173 | 1,123,242 | 4,263,669 | 46,210 | 4,933,870 | 12,290,000 | | 22,656,991 | 10,372,607 | 12,435,000 | 22,807,607 | 10,383,840 | 12,500,000 | 22,883,840 |
| 214 | Ministria e Punëve të Brendshme | 10,364 | 74,480,460 | 18,981,845 | 2,036,500 | 2,821,867 | 16,193,600 | | 114,514,272 | 98,693,074 | 18,150,000 | 116,843,074 | 99,437,878 | 20,550,000 | 119,987,878 |
| 215 | Ministria e Drejtësisë | 1,947 | 12,683,196 | 4,657,349 | 922,169 | | 1,092,000 | | 19,354,714 | 18,326,130 | 1,105,000 | 19,431,130 | 18,452,962 | 1,220,000 | 19,672,962 |
| 216 | Ministria e Punëve të Jashtme | 275 | 5,560,891 | 12,703,547 | 538,051 | 100,000 | 1,556,564 | | 20,459,053 | 18,930,293 | 1,625,000 | 20,555,293 | 18,985,902 | 1,740,000 | 20,725,902 |
| 217 | Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës | 3,324 | 20,740,387 | 10,765,230 | 950,000 | | 18,580,000 | | 51,035,617 | 38,470,000 | 18,730,000 | 57,200,000 | 42,169,419 | 18,840,600 | 61,010,019 |
| 218 | Ministria për Integrime Evropiane | 86 | 643,242 | 770,962 | 10,500 | 250,000 | 5,200 | | 1,679,904 | 1,677,920 | - | 1,677,920 | 1,684,352 | | 1,684,352 |
| 219 | Ministria e Diasporës | 66 | 478,748 | 992,314 | 25,500 | 130,000 | | | 1,626,562 | 1,628,956 | | 1,628,956 | 1,633,743 | | 1,633,743 |
| 230 | Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik | 39 | 307,800 | 117,253 | 5,000 | | | | 430,053 | 431,592 | | 431,592 | 434,670 | | 434,670 |
| 231 | Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës | 55 | 714,908 | 324,943 | 5,000 | | 50,000 | | 1,094,851 | 1,048,425 | 65,000 | 1,113,425 | 1,055,574 | 70,000 | 1,125,574 |
| 235 | Autoriteti i Rregullator i Komunikimeve Elektronike dhe Postare | 39 | 408,136 | 357,232 | 12,700 | | 400,000 | | 1,178,068 | 780,109 | 1,000,000 | 1,780,109 | 784,190 | 1,500,000 | 2,284,190 |
| 236 | Agjencioni Kundër-Korrupsion | 40 | 358,256 | 138,908 | 8,500 | | | | 505,664 | 507,455 | | 507,455 | 511,037 | | 511,037 |
| 238 | Zyra Rregullatorit për Energji | 33 | 476,184 | 199,332 | 22,000 | | 70,800 | | 768,316 | 699,897 | 72,800 | 772,697 | 704,659 | 75,000 | 779,659 |
| 240 | Organi Shqyrtues i Prokurimit | 23 | 210,240 | 114,355 | 5,100 | | 20,000 | | 349,695 | 330,746 | 25,000 | 355,746 | 332,848 | 30,000 | 362,848 |
| 241 | Agjencia për Ndihmë Juridike Falas | 22 | 190,716 | 128,192 | 14,917 | | | | 333,825 | 334,778 | | 334,778 | 336,685 | | 336,685 |
| 242 | Univerziteti i Prishtinës | 2,081 | 20,804,494 | 2,638,845 | 1,240,000 | 1,299,000 | 3,500,000 | | 29,482,339 | 26,086,362 | 3,650,000 | 29,736,362 | 26,294,407 | 3,900,000 | 30,194,407 |
| 243 | Gjykata Kushtetuese e Kosovës | 66 | 1,022,548 | 489,965 | 4,000 | | 25,000 | | 1,541,513 | 1,517,025 | 35,000 | 1,552,025 | 1,527,250 | 38,000 | 1,565,250 |
| 244 | Autoriteti Kosovar i Konkurencës | 23 | 160,104 | 59,861 | 13,000 | | 20,000 | | 252,965 | 233,766 | 20,000 | 253,766 | 235,367 | 22,000 | 257,367 |
| 245 | Agjencioni Kosovar i Intelegjencës | 90 | 3,450,000 | 1,320,282 | 34,500 | 200,000 | 1,500,000 | | 6,504,782 | 5,022,032 | 1,550,000 | 6,572,032 | 5,056,532 | 1,600,000 | 6,656,532 |
| 246 | Këshilli i Kosovës për Trashigimi Kulturore | 16 | 108,829 | 85,418 | 2,550 | | | | 196,797 | 197,341 | | 197,341 | 198,429 | | 198,429 |
| 247 | Paneli Zgjedhor per Ankesa dhe Parashtesa | 20 | 130,727 | 73,613 | 7,820 | | 5,000 | | 217,160 | 212,813 | - | 212,813 | 214,120 | | 214,120 |
| 249 | Këshilli i Pavarur Mbikqyrës për Sherbimin Civil të Kosovës | 26 | 236,507 | 107,402 | 3,825 | | 25,000 | | 372,734 | 348,916 | - | 348,916 | 351,281 | | 351,281 |
| 250 | Keshilli Prokurororial i Kosoves | 698 | 6,600,000 | 1,426,552 | 199,630 | | 1,257,500 | | 9,483,682 | 8,259,182 | 1,287,500 | 9,546,682 | 8,325,182 | 1,340,000 | 9,665,182 |
| 302 | Zyra Kombetare e Auditimit | 160 | 1,767,505 | 551,289 | 34,000 | | 45,000 | | 2,397,794 | 2,361,631 | 45,000 | 2,406,631 | 2,379,306 | 60,000 | 2,439,306 |
| 313 | Zyra Rregullative e Ujit dhe Mbeturinave | 21 | 217,736 | 134,495 | 6,503 | | | | 358,734 | 359,823 | | 359,823 | 362,000 | | 362,000 |
| 314 | Autoriteti Regullativ i Hekurudhave | 20 | 167,544 | 114,179 | 11,900 | | | | 293,623 | 294,461 | | 294,461 | 296,136 | | 296,136 |
| 317 | Autoriteti i Aviacionit Civil | 30 | 688,484 | 223,052 | 13,738 | | | | 925,274 | 928,716 | | 928,716 | 935,601 | | 935,601 |
| 318 | Komsioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve | 77 | 780,100 | 386,281 | 30,600 | | 190,000 | | 1,386,981 | 1,200,881 | 210,000 | 1,410,881 | 1,208,682 | 250,000 | 1,458,682 |
| 319 | Komisioni i Pavarur i Mediave | 31 | 388,292 | 347,984 | 28,000 | | 450,000 | | 1,214,276 | 766,217 | 460,000 | 1,226,217 | 770,100 | 470,000 | 1,240,100 |
| 320 | Komisioni Qendror i Zgjedhjeve | 88 | 707,864 | 6,436,269 | 48,391 | 4,200,000 | 225,800 | | 11,618,324 | 11,396,063 | 225,800 | 11,621,863 | 5,403,142 | | 5,403,142 |
| 321 | Institucioni i Avokatit të Popullit | 78 | 920,366 | 324,353 | 25,500 | | 66,000 | | 1,336,219 | 1,274,821 | 66,000 | 1,340,821 | 1,284,025 | 70,000 | 1,354,025 |
| 322 | Instituti Gjyqësor i Kosovës | 25 | 204,384 | 430,000 | 16,500 | | 13,000 | | 663,884 | 651,906 | 13,000 | 664,906 | 653,950 | 15,000 | 668,950 |
| 328 | Këshilli Gjyqësor i Kosovës | 2,159 | 16,474,761 | 3,813,079 | 450,000 | 250,000 | 820,000 | | 21,807,840 | 21,070,214 | 845,000 | 21,915,214 | 21,234,961 | 920,000 | 22,154,961 |
| 329 | Agjencia Kosovare i Pronës | 242 | 1,163,790 | 554,145 | 98,023 | | 43,700 | | 1,859,658 | 1,821,777 | 45,700 | 1,867,477 | 1,833,415 | | 1,833,415 |
| 251 | Agjensioni Shtetëror për Mbrojtjen e të Dhënave Personale | 23 | 216,344 | 130,448 | 6,450 | | | | 353,242 | 354,324 | | 354,324 | 356,488 | | 356,488 |
| 253 | Agjencioni për Menaxhimin e Kompleksëve Memoriale | 12 | 87,007 | 44,871 | 30,000 | | 2,000,000 | | 2,161,878 | 162,313 | 2,100,000 | 2,262,313 | 163,183 | 2,350,000 | 2,513,183 |
| 232 | Shpenzimet e Paparashikuara | | | | | | 4,000,000 | 5,000,000 | 9,000,000 | 5,000,000 | 4,000,000 | 9,000,000 | 2,000,000 | 4,000,000 | 6,000,000 |
| 248 | Radio Televizioni I Kosoves | | | | | 9,600,000 | | | 9,600,000 | 9,600,000 | | 9,600,000 | 9,600,000 | | 9,600,000 |
| | Fondi për shpenzime të reja kapitale nga klauzola e investimeve | | | | | | 105,000,000 | | | | 105,000,000 | | | 105,000,000 | |
| | Fondi investiv nga mjetet e AKP | | | | | | 38,000,000 | | | | 90,000,000 | | | 100,000,000 | |
| | **Totali 2016** | **38,573** | **313,142,809** | **152,866,945** | **16,855,845** | **466,696,000** | **595,148,240** | **5,000,000** | **1,406,709,839** | **992,237,685** | **612,927,050** | **1,410,164,735** | **1,029,084,895** | **662,403,423** | **1,486,488,318** |
| 239 | Agjencioni Kosovar i Privatizimit | 258 | 4,402,884 | 2,380,000 | 98,000 | 40,000 | 100,000 | | 7,020,884 | 6,942,898 | 100,000 | 7,042,898 | 6,986,926 | 100,000 | 7,086,926 |
| 254 | Agjencioni për Shërbimet e Navigimit Ajror | 160 | 2,238,918 | 736,388 | 55,000 | | 1,028,589 | | 4,058,895 | 3,041,501 | 2,020,000 | 5,061,501 | 3,063,890 | 2,030,000 | 5,093,890 |
| | **Totali i përgjithshëm me AKP dhe ASHNA** | **38,991** | **319,784,611** | **155,983,333** | **17,008,845** | **466,736,000** | **596,276,829** | **5,000,000** | **1,417,789,618** | **1,002,222,084** | **615,047,050** | **1,422,269,134** | **1,039,135,711** | **664,533,423** | **1,498,669,134** |